

Konkluzionet për Lirinë e Lëvizjes dhe Licencimin/ Bruksel 16 shtator 2014

- Pala e Beogradit ka informuar në vendimin për zgjerimin e mëtejshëm të aranzhimeve për lëvizjen e lirë në Aeroportin Ndërkombëtar të Bogradit Nikola Tesla me datë 22 shtator në ora 08:00 dhe në pesë pika të tjera të kalimit përgjatë dy muajve të ardhshëm (Kelebija, Gradina, Preshevë, Sid dhe Aeroportin e Nishit më 15 nëntor);
- Pala e Beogradit ka theksuar që paraqitja e vulave doganore do të rishikohet brenda një muaji për të siguruar përdorimin e emërtimit konsistent me marrëveshjen e 17 janarit të vitit 2013;
- Pala e Beogradit ka theksuar se përdorimi i emërtimit “Kosovë” në formën SAD do të rishikohet;
- Palët kanë konfirmuar konkluzionet e arritura më 17 janar, 3 tetor, 5 nëntor 2013 dhe më 9 prill 2014;
- Palët sidomos kanë rikujtuar se:
 1. Nuk kërkohet regjistrim për kompanitë e themeluara në veri të Kosovës para Marrëveshjes për Mbledhjen e të Hyrave Doganore të arritur me 17 Janar 2013.
 2. Licencimi është i domosdoshëm vetëm për kompanitë që importojnë mallra;
 3. Dokumentacioni lëshuar nga MNAO (Zyra Administrative për Mitrovicë të Veriut) për këto kompani e përbën aplikacionin fillestar për licencim, i cili duhet të plotësohet me dokumentacion shtesë;
 4. MNAO (Zyra Administrative për Mitrovicë të Veriut) do të ofroj shërbimet e saj në përputhje me paragrafin 9 të konkluzioneve të 5 nëntorit 2013;
 5. Procesi i licencimit për mallrat e kontrolluara duhet të përfundojë deri më 31 dhjetor 2014.

(përkthim jo zyrtar)